



Sugjerime dhe truke për temën...

Konsumi i mediave

TV, tablete dhe celularë nuk janë ruajtës fëmijësh!

Konsumi i mediave

TV, tablete dhe celularë nuk janë ruajtës fëmijësh! Konsumi i mediave nuk e nxit zhvillimin e lojës dhe të gjuhës së fëmijëve të vegjël. Shikimi i tepërt i televizorit i bën dëm fëmijës suaj. Truri i një fëmije të vogël është i mbingarkuar nga imazhet e shpejta të televizorit. Me këtë fëmija lodhet më shpejt, bëhet pasiv dhe mund të mësojë më pak mirë.

Ju mund të bëni këtë:

- Televizorë dhe tablete nuk duhet të vendosen në dhomën e fëmijëve.
- Mos lini që të shikojë bebja juaj ose foshnja juaj televizor ose të luajë në tablet dhe celular. Fëmijë në moshën e kopshtit të fëmijëve duhet të rrinë jo më shumë se gjysmë ore në ditë para ekranit.
- Konsumi i mediave duhet t'i përshtatet moshës së fëmijës si nga ana e përmbajtjes, ashtu edhe nga ana e sasisë.
- Mos e lini televizorin gjithë ditën të ndezur.
- Mos lini që t'ju tërhiqet vëmendja vazhdimisht nga celulari juaj.
- Mos surfoni në internet në praninë e fëmijës suaj.
- Dhurojini vetes një pushim të përdorimi të mediave, kur jeni rrugës me fëmijën tuaj.
- Mos bëni që fëmija juaj të merret dhe të qetësohet me mediat e ekranit.

Meqë ra fjala:

Për zhvillimin e shëndoshë fëmijët kanë nevojë për vëmendjen tuaj të pandarë, për kontakt me sy, përvoja vetjake të shqisave dhe shumë mundësi për të lëvizur në ajrin e freskët.

Früherziehungsdienst des Kantons Bern FED

Geschäftsstelle, Frankenstrasse 1, 3018 Bern

Telefon 031 869 18 78, info@fed-be.ch, www.fed-be.ch